



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 334/2 Prot.

Tiranë, më 19.10.2022

**V E N D I M**  
**Nr. 127 datë 19.10.2022**

***“Mbi paralajmërimin e institucionit Këshilli i Qarkut Vlorë, për marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e marrëdhënies në shërbimin civil, për nëpunësit që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dhe në zbatim të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, e konkretisht nenit 92, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, si dhe të Vendimit nr. 4, datë 14.01.2022 “Për fillimin e Mbikëqyrjes mbi situatën e marrëdhënies të punësimit në shërbimin civil, të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të hetimit administrativ mbi gjendjen e marrëdhënies në shërbimin civil, të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë,

**VËREJ SE:**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në zbatim të nenit 65, germa “c”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, dispozitë e cila urdhëron përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil për ata nëpunës të cilët kanë plotësuar moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, ka realizuar procesin e verifikimit lidhur me zbatimin e ligjit në këtë rast, në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë.

Për të realizuar këtë proces, është kërkuar nga njësitë përgjegjëse të institucioneve që përfshihen në shërbimin civil, të raportojnë në lidhje me ata nëpunës, të cilët megjithëse kanë plotësuar moshën e pensionit të pleqërisë, ende vazhdojnë marrëdhënien e punës në pozicione të shërbimit civil.

Në këtë proces është përfshirë edhe institucioni i Këshillit të Qarkut Vlorë, i cili pas kërkesës së Komisionerit për informacion, nëpërmjet shkresës nr. 820/1 prot., datë 26.05.2022, ka raportuar në lidhje me punonjësit që plotësojnë moshën e pensionit të plotë të pleqërisë deri në fund të vitit kalendarik.

Nga verifikimi rezultoi se, nëpunësja \*\*\*\*\*, e ditëlindjes 12.03.1961, emëruar në pozicionin e punës “Përgjegjese e Sektorit të Urbanistikës, Zhvillimit të Territorit, Burimeve Njerëzore, Arsimit, Kulturës, Turizmit dhe Çështjeve Sociale”, megjithëse ka plotësuar që në datën 12.07.2022, moshën për të përfituar pension të plotë pleqërie referuar nenit 92, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, vazhdon ende marrëdhënien e punës.

Në lidhje me këtë aspekt të administrimit të shërbimit civil, në përmbajtjen e nenit 65, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, evidentohen në mënyrë të shprehur rastet e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil për shkak të ligjit, si edhe afati dhe organi që konstaton rrethanat, si më poshtë:

“1. Marrëdhënia në shërbimin civil përfundon për shkak të ligjit kur:

- a) nëpunësi vdes apo kur merr formë të prerë vendimi për deklarimin e vdekjes së tij;
- b) nëpunësi humbet shtetësinë shqiptare apo merr formë të prerë vendimi i gjykatës për kufizimin apo heqjen e zotësisë për të vepruar;
- c) plotësohet moshja për pensionin e plotë të pleqërisë;
- ç) konstatohet pavlefshmëria e aktit të emërimit;
- d) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale.

2. Përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ligjit, konstatohet 5 ditë nga ndodhja apo njohja e tij nga:

- a) njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi ushtron detyrën;
- b) DAP-i për anëtarët e TND-së.”

Në këto kushte, plotësimi i moshës për pensionin e plotë të pleqërisë, është një prej rasteve që parashikohet në pikën 1/c, të kësaj dispozite dhe për këtë arsye, njësia e burimeve njerëzore të institucionit, ku nëpunësi ushtron aktualisht detyrën, në zbatim të pikës 2/a, të nenit të sipërcituar, duhet të veprojë menjëherë duke e konstatuar këtë fakt. Pas konstatimit të plotësimin të moshës për përfitimin e pensionit të plotë të pleqërisë nga nëpunësi civil \*\*\*\*\*, brenda afatit 5 ditor të përcaktuar në ligj duhet të dalë akti i lirim të tij nga shërbimi civil.

Pozicioni i punës i cili do të mbetet i lirë pas këtij veprimi, duhet të shpallet vakant, për t’u plotësuar, sipas procedurës dhe kërkesave të neneve 21, 22, 23 etj., të ligjit në fjalë.

### **Për këto arsye:**

Për sa u analizua më sipër, bazuar në nenin 15, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, pikës 9, të nenit 16, të rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, si dhe të Vendimit nr. 4, datë 14.01.2022, “Për fillimin e Mbikëqyrjes mbi situatën e marrëdhënieve të punësimit në shërbimin civil, të nëpunësve që kanë plotësuar moshën e pensionit të plotë të pleqërisë”, të Komisionerit,

## V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga Njësia Përgjegjëse e Këshillit të Qarkur Vlorë, marrjen e masave të menjëhershme për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë, duke përfunduar marrëdhënien në shërbimin civil për shkak të ligjit, për punonjësen \*\*\*\*\* në pozicionin e punës *“Përgjegjëse e Sektorit të Urbanistikës, Zhvillimit të Territorit, Burimeve Njerëzore, Arsimit, Kulturës, Turizmit dhe Çështjeve Sociale”*.
2. Pozicioni respektiv i punës të përfshihet në planin e rekrutimit dhe të shpallet menjëherë si pozicion i lirë. Të fillojë procedura për plotësimin e këtij pozicioni sipas kërkesave të legjislacionit të shërbimit civil.
3. Kryerja e veprimeve të mësipërme duhet të bëhet brenda **30** ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim.
4. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi, si dhe të dërgojë aktet administrative të cilat vërtetojnë realizimin e detyrave.
5. Në rast të mosrespektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrimet e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.
6. Të njoftohet për këtë vendim Kryetari i Këshillit të Qarkur Vlorë dhe Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore pranë këtij institucioni.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**